



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova



Komuna Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr. 1403/2025
Data: 26.12.2025

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Kryetari i Komunës bazuar në Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në Nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2010 i miratuar me datë 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën e datës 03.12.2025 të parashtruar nga Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim, për themelimin e Komisionit për verifikimin e punimeve për projektin: Lot3 "Ndërtimi i rrugës në lagjen Gerguri dhe Berishaj në Llukac të Begut"; Lot4 "Ndërtimi i rrugëve në Istog të Poshtëm, lagjet e reja-projekt 2 vjeçar", nxjerr:

V E N D I M

1. **THEMELOHET:** Komisioni për verifikimin e punimeve për projektin: Lot3 "Ndërtimi i rrugës në lagjen Gerguri dhe Berishaj në Llukac të Begut"; Lot4 "Ndërtimi i rrugëve në Istog të Poshtëm, lagjet e reja-projekt dy vjeçar", me numër të jashtë prokurimi 633-25-5440-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-25-025-5-2-1/C1014, të cilin projekt e ka realizuar operatori ekonomik "GRANIT" SH.P.K., nga Komuna e Istogut dhe në komision caktohen:

- 1.1. Alban Llapaj, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Migjen Maxharraj, anëtar;
- 1.3. Ardon Arifaj, anëtar.

2. Komisioni i lartcekur do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projektit të cekura në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftoj kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftoj Menaxherin e kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës; do të hartoj procesverbalin gjatë verifikimit të punimeve në terren; do të hartoj raportin e verifikimit të punimeve; do të njoftoj Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektin e lartcekur si dhe do t'i kryejë punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për verifikimin e punëve për projektin e lartcekur e merr Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Komisioni dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim,
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



Republika e Kosovës-Komuna e Istogut
Republika Kosovo-Opština Istok
Republic of Kosova-Istog Municipality



Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr.1402/025
Data: 23.12.2025

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Kryetari i Komunës, bazuar në Nenin 13 dhe 58 të Ligjit 03/L.040 për Vetëqeverisje Lokale, në Nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në Nenin 35 të Ligjit NR.08/L-197 për Zyrarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.21/2023) në fuqi nga 18 shtatori 2023 dhe në Nenin 68 të Statutit 01Nr.62/2010 të Komunës së Istogut i miratuar me datën 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën 06Nr.364/2025 të datës 02.12.2025, të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi i njoftuar me shkresë Fisnik Shoshaj, Menaxher i Personelit, për caktimin e Ushtruesit të detyrës së Koordinatorit për cilësi në QKMF dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 06Nr.364/2025 e datës 02.12.2025, e parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi i njoftuar me shkresë Fisnik Shoshaj, Menaxher i Personelit, për caktimin e Ushtruesit të detyrës së Koordinatorit për cilësi në QKMF për gjashtë (6) muaj.
2. Ushtrues detyre të Koordinatorit për cilësi në QKMF për gjashtë (6) muaj caktohet Arlinda Demaj, Zyrtare e Pasurisë, e cili mund të ushtroj këtë detyrë nga data 01.01.2026.
3. Mbas përfundimit të afatit të cekur në pikën 2. të këtij Vendimi, nëpunësja publike e cekur kthehen në pozitën e mëparshme sipas paragrafit 5 të nenit 35 të Ligjit NR. 08/L-197 për Zyrarët Publikë.
4. Obligohet Zyrtarja Financiare-Përgjegjëse për Paga, Mëditje dhe Kompensime që këtë Vendim të dërgoj në Ministrinë e Financave Punëve dhe Transfereve-Divizionit të Pagave, që Arlinda Demaj të futet në listën e pagave Ushtrues Detyre në pozitën e punës: Koordinatorit për cilësi në QKMF për gjashtë (6) muaj.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Menaxheri i Personelit, Drejtori i QKMF-së, Zyrtarja Financiare-Përgjegjëse për Paga Mëditje dhe Kompensime dhe Arlinda Demaj.
6. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi ka parashtruar kërkesën 06Nr.354/2025 të datës 02.12.2025, i njoftuar me shkresë Fisnik Shoshaj, Menaxher i Personelit, për caktimin e Arlinda Demaj, Ushtrues Detyre e Koordinatorës për Cilësi në QKMF.

Kryetari i Komunës pas shqyrtimit të kërkesës së lartpërmendur, e miratohet propozimin e Menaxherit të Personelit për caktimin e Arlinda Demaj, Ushtrues Detyre të Koordinatorës për Cilësi në QKMF, për gjashtë (6) muaj, nga data 01.01.2026 deri me datën 01.07.2026.

Mbas përfundimit të afatit të cekur në pikën 2. të këtij Vendimi, Arlinda Demaj kthehet në pozitën e mëparshme sipas paragrafit 5 të nenit 35 të Ligjit NR. 08/L-197 për Zyrarët Publikë.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Shëndetësi,
- Fisnik Shoshaj, Menaxher i NJBNJ,
- Drejtorit të QKMF-së,
- Arlinda Demaj,
- Zyrtares Financiare-Përgjegjëse për Paga Mëditje dhe Kompensime dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqësja e Sektorit Ligjor
znj.Zelëje SUTAJ

Kryetari i Komunës
z.Hir FERATI





Republika e Kosovës-Komuna e Istogut
Republika Kosovo-Opština Istok
Republic of Kosovo-Istog Municipality



Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr.1401/2025
Data: 23.12.2025

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Kryetari i Komunës, bazuar në Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në Nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), Nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 i miratuar me datë 30.11.2010 dhe nenin 11 paragrafi 1 nenparagrafi 1.4 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 001Nr.146/2025. Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare në Drejtorinë për Shëndetësi, shqyrtoi kërkesën 06Nr-553-46589 të datës 19.12.2025 të parashtruar nga Hamdi Dekaj nga fsh. Istog i Poshtëm, Komuna Istogut, për përkrahje financiare me derivateve dhe me procesverbal. Nr.373/2025 të datës 22.12.2025 i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

- 1. MIRATOHET:** kërkesa 06Nr-553-46589 e datës 19.12.2025 e parashtruar nga Hamdi Dekaj për përkrahje me karburant për marrjen e terapisë për tetë seanca në klinikën e Onkologjisë në QSKUK-Prishtinë për gjashtë muaj dhe i ndahen njëqind e njëzet (120) nga pesëmbëdhjetë (15) litra karburant për një seancë.
2. Obligohet Zyrtari i transportit që Hamdi Dekaj të pajisë me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit si në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Zyrtari i Transportit.
4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Hamdi Dekaj
- Drejtorisë për Shëndetësi,
- Zyrtarit të Transportit dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ

Kryetari i Komunës
z.Illir FERATI





Republika e Kosovës-Komuna e Istogut
Republika Kosovo-Opština Istok
Republic of Kosova-Istog Municipality



Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr.1400/2025

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Data: 23.12.2025

Kryetari i Komunës, bazuar ne Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne Nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), Nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 i miratuar me datë 30.11.2010 dhe nenin 11 paragrafi 1 nenparagrafi 1.4 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 001Nr.146/2025. Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare në Drejtorinë për Shëndetësi, shqyrtoi kërkesën 06Nr-553-46604 të datës 19.12.2025 të parashtruar nga Raza Rugova nga fsh. Llokac i Begut, Komuna Istogut, për përkrahje financiare me derivateve dhe me procesverbal Nr.374/2025 të datës 22.12.2025 i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

- 1. MIRATOHET:** kërkesa 06Nr-553-46604 e datës 19.12.2025 e parashtruar nga Raza Rugova për përkrahje me karburant për marrjen e terapisë për gjashtë seanca në klinikën e Onkologjisë në QSKUK-Prishtinë për gjashtë muaj dhe i ndahen nëntëdhjetë (90) litra karburant nga pesëmbëdhjetë (15) litra karburant për një seancë.
2. Obligohet Zyrtari i transportit që Raza Rugova të pajisë me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit si në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Zyrtari i Transportit.
4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Raza Rugova,
- Drejtorisë për Shëndetësi,
- Zyrtarit të Transportit dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor

znj. Zekije SUTAJ

Kryetari i Komunës
z.Illir FERATI





Republika e Kosovës-Komuna e Istogut
Republika Kosovo-Opština Istok
Republic of Kosovo-Istog Municipality



Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr.1399/025
Data: 23.12.2025

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Kryetari i Komunës, në pajtim me Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne Nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), Nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 i miratuar me datë 30.11.2010, shqyrtoi kërkesën 01Nr-016-45298 të datës 08.12.2025 të parashtruar nga Federata e Futbollit të Kosovës në Prishtinë, për realizimin e projektit për zhvillimin e infrastrukturës futbollistike në Republikën e Kosovës përfshirë edhe Komunën e Istogut, nxjerr:

V E N D I M

- MIRATOHET:** kërkesa 01Nr-016-45298 e datës 08.12.2025 e parashtruar nga Federata e Futbollit të Kosovës në Prishtinë, për realizimin e projektit për zhvillimin e infrastrukturës futbollistike në Republikën e Kosovës përfshirë edhe fushën e futbollit në Istog stadiumin "Demush Mavraj" për një periudhë minimale njëzet (20) vitesh me prioritet për zhvillimin e programeve të ndryshme nga FIFA dhe UEFA.
- Qëllimi i këtij projekti është instalimi dhe funksionalizimi i sistemit të ndriçimit me teknologji LED në fushën e futbollit në komunën e Istogut i cili do të ketë ndikim drejtpërdrejtë në zhvillimin e futbollit lokal duke mundësuar trajnime, ndeshje zyrtare dhe aktivitete futbollistike edhe gjatë orëve të mbrëmjes si dhe do të kontribuoj në përmirësimin e kushteve për klubet, të rinjtë dhe komunitetin sportiv në tërësi.
- Zyrtari për Kulturë, Rini dhe Sport do të bashkëpunoj me Federatën e Futbollit të Kosovës për realizimin e këtij projekti në fushën e futbollit në Istog stadiumin "Demush Mavraj".
- Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Zyra e Kryetarit dhe Zyrtari për Kulturë Rini dhe Sport.
- Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap Konflikt Administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimt të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Federatës Futbollit të Kosovës,
- Zyrës Kryetarit,
- Zyrtarit për Kulturë, Rini dhe Sport dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
z.Illir FERATI





Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr.1398/025
Data: 22.12.2025

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Kryetari i Komunës, në pajtim me dispozitat e Nenit 58 shkronja b), Nenin 62 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008); Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtaret Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.21/18 shtator 2023 dhe në pajtim me shtojcën Nr.1.3 lidhur me shtojcën Nr.1 të Rregulloren (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, për nënshkrim në emër të drejtorive, jep këtë:

A U T O R I Z I M

Më të cilin autorizon:

1. **z.Genc Ademaj**, Drejtor i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, të nënshkruaj në emër të gjitha drejtorive;
2. **z.Dukagjin Hoxhaj**, Drejtor i Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis, të nënshkruaj në emër të Drejtorisë për Gjeodezi e Kadastër;
3. **z.Brahim Hetemaj**, Udhëheqës i Sektorit për Shëndetësi, të nënshkruaj në emër të Drejtorisë për Shëndetësi;
4. **z.Naser Gjocaj**, Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike, të nënshkruaj në emër të Drejtorisë për Shërbime Publike;
5. **z.Valentina Bytyçi**, Zyrtare për Çështje Pedagogjike, të nënshkruaj në emër të Drejtorisë Komunale të Arsimit;
6. **z.Fadil Kabashi**, Udhëheqës i Sektorit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, të nënshkruaj në emër të Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural;
7. **z.Xhavit Blakaj**, Udhëheqës i Sektorit për Inspektion, të nënshkruaj në emër të Drejtorisë për Inspektion.

Autorizimi vlen nga data 19.12.2025 e deri në një vendim tjetër.

Autorizimi i dërgohet:

- Genc Ademaj,
- Dukagjin Hoxhaj,
- Brahim Hetemaj,
- Naser Gjocaj,
- Zizë Bujupaj,
- Fadil Kabashi,
- Xhavit Blakaj dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
z.Illir FERATI





Republika e Kosovës-Komuna e Istogut
Republika Kosovo-Opština Istok
Republic of Kosova-Istog Municipality



Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr.1397 /025
Data: 22.12.2025

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne Nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 10 paragrafi 1 nen paragrafi 1.3 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 01.Nr.146/2025 i miratuar me datë 22.09.2025. Drejtoria për Shërbime Publike shqyrtoi kërkesën 08.Nr.553-2374 të datës 17.01.2025 të parashtruar nga Rrushe Idrizaj adresa Istog rruga "Seli Bajramaj" për kompensim demi të shkaktuara në pronë private dhe me shkresë të datës 19.12.2025 i propozon Kryetarit të Komunës të nxjerr:

V E N D I M

- 1. MIRATOHET:** Kërkesa.06.Nr.553-2374 e datës 17.01.2025 e parashtruar nga **Rrushe Idrizaj** për përkrahje financiare, për shkak të demit të shkaktuar në pronë private gjatë ndërtimit të kanalizimit në fshatin Kërminë dhe sipas procesverbalit të Komisionit të Drejtorisë për Shërbime Publike i ndahen mjete financiare në shumës prej pesëqindetridhjetë euro (530.00€) nga kategoria ekonomike subvencionë dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike.
2. Mjetet e miratuara si në pikën 1 të këtij vendimi do të transferohen në gjyrollogarinë bankare të Rrushe Idrizaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësiave.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike.
4. Vendimi është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap Konflikt Administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Rrushe Idrizaj,
- Drejtorisë për Shërbime Publike dhe
- Arkivit të Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
z. Ilir FERAT





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Istogut
Opština Istok - Municipality Istog



KRYETARI I KOMUNËS
PREDSIEDNIK OPŠTINE
MUNICIPAL MAYOR

01 Nr.139/2025

Datë: 22.12.2025

Kryetari i Komunës, bazuar ne Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne Nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), Nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 i miratuar me datë 30.11.2010 dhe nenin 11 paragrafi 1 nenparagrafi 1.4 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 001Nr.146/2025. Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare Drejtoria për Shëndetësi, shqyrtoi kërkesën 06Nr-553-46312 të datës 17.12.2025 të parashtruar nga Emine Dreshaj nga Prigoda Komuna e Istogut, i cili ka të bëjë për kompensim te derivateve për transport ne shërbimin e Onkologjis pranë QSKUK-së me procesverbal. Nr.371/2025 të datës 17.12.2025 i propozon Kryetarit të nxjerr:

VENDIM

- MIRATOHET:** kërkesa 06Nr-553-46312 e datës 17.12.2025 e parashtruar nga Emine Dreshaj për përkrahje me karburant për marrjen e shërbimit te Onkologjis ne QSKUK-së për trajtimin e kimio-terapis dhe rrezatimeve ne QKUK dhe përkrahet me nga 15 litra karburant për një seancë, dhe i ndahen treqind (300) litra karburant.
- Obligohet Zyrtari i transportit që Valon Metaj të pajisë me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit si në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi.
- Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Zyrtari i Transportit.
- Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapë konfliktin administrativ pranë Gjykatës Komerciale në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Emine Dreshaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi,
- Zyrtarit të Transportit dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ

Kryetari i Komunës
z.Illir FERATI





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova



Komuna Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr. 1394/2025
Data: 19.12.2025

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Kryetari i Komunës bazuar në Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në Nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2010 i miratuar me datë 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën e datës 19.12.2025 të parashtruar nga Zyra e Kryetarit, për themelimin e Komisionit për verifikimin e punimeve për projektin: "Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit", nxjerr:

V E N D I M

1. THEMELOHET: Komisioni për verifikimin e punimeve për projektin: "Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit", me numër të jashtë prokurimi 633-25-9993-1-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-25-072-1-2-1, të cilin projekt e ka realizuar operatori ekonomik "AEM ELEKTRIK" SH.P.K., nga Istogu dhe në komision caktohen:

- 1.1. Armend Keraj, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Aida Kelmendi, anëtare;
- 1.3. Liliana Frrokaj, anëtare.

1.1. Armend Keraj, Kryesues i Komisionit;
1.2. Aida Kelmendi, anëtare;
1.3. Liliana Frrokaj, anëtare.

2. Komisioni i lartcekur do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projektit të cekura në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftojë Menaxherin e kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës; do të hartojë procesverbalin gjatë verifikimit të punimeve në terren; do të hartojë raportin e verifikimit të punimeve; do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektin e lartcekur si dhe do t'i kryejë punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për verifikimin e punëve për projektin e lartcekur e merr Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Komisioni dhe Zyra e Kryetarit.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Zyrës Kryetarit,
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
z.Illir FERATI





Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr.1393/025
Data: 18.12.2025

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Kryetari i Komunës, bazuar ne Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne Nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), Nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 i miratuar me datë 30.11.2010 dhe nenin 4 paragrafi 1.1, Neni 12 paragrafi 1.5 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.146/2025 e miratuar me datë 31.07.2025. Komisioni për shqyrtimin e kërkesave të nënave lehona në Zyrën e Kryetarit, shqyrtoi kërkesën 01Nr.400-32602 të datës 02.09.2025 të parashtruar nga Doruntinë Haskaj nga fsh. Dragolec, Komuna Istogut, për përkrahje financiare me rastin e lindjes së fëmijës dhe me procesverbal të datës 04.12.2025 i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 01Nr.400-32602 e datës 02.09.2025 e parashtruar nga Doruntinë Haskaj, për përkrahje financiare me rastin e lindjes dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej njëqind e pesëdhjetë euro (150.00€) nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit, si ndihmë momentale për shërim.

2. Mjetet financiare të miratuara në pikën 1 të këtij Vendimi do të transferohen në xhirollogarinë e Doruntinë Haskaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisive.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Zyra e Kryetarit.

4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap Konflikt Administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda një afati prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Doruntinë Haskaj,
- Zyrës Kryetarit,
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
z.Illir FERATI





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova



Komuna Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr. 1391/2025

Data: 16.12.2025

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar në nenin 69 paragrafi 4 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010 i miratuar me datën 30.11.2010 dhe bazuar në Kontratën për ndarjen e mjeteve financiare të lidhur në mes të komunës së Istogut dhe OJQ-së "Forca e Gruas", nxjerr:

V E N D I M

1. Ndahen mjete buxhetore sipas Kontratës për ndarjen e mjeteve financiare të lidhur në mes të komunës së Istogut dhe OJQ-së "Forca e Gruas" në shumë prej katërmijë euro (4,000.00€) nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i zyrës së Kryetarit.
2. Mjetet e miratuara në pikën 1 të këtij vendimi do të transferohen në xhirollogaritë e OJQ-së "Forca e Gruas", në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Zyra e Kryetarit.
4. Vendimi është përfundimtarë.

Vendimi i dërgohet:

- Zyra e Kryetarit,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
z.Illir FERATI





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova



Komuna Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr: 1387/2025

Data: 16.12.2025

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pikë b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar në nenin 25, neni 68 paragrafi 1 nenparagrafi 1.8 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyratet Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.21/2023), nenin 13 paragrafi 2 nenparagrafi 2.1. të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L197 për Zyratet Publike, shqyrtoj kërkesën 02Nr.214/2025 të datës 15.12.2025 të parashtruar nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, për pezullimin e vendit të punës për Emina Coković, Zytare për Buxhet dhe Financa, nxjerr:

V E N D I M

Për pezullimin e përkohshëm të marrëdhënies së punës

- MIRATOHET:** kërkesa 02Nr.214/2025 e datës 15.12.2025 e parashtruar nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, që Emina Coković, Zytare për Buxhet dhe Financa, i pezullohet përkohësisht marrëdhënia e punës pa pagesë, për shkak të kandidimit për deputetë në Kuvendin e Kosovës, në zgjedhjet Parlamentare të datës 28 dhjetor 2025.
- Pezullimi i përkohshëm i marrëdhënies së punës sipas pikës 1 të këtij vendimi fillon 7(shtatë) ditë para periudhës së hapjes zyrtare të fushatës dhe përfundon 5(pesë) ditë pas mbylljes zyrtare të fushatës konkretisht nga data 09.12.2025 deri me datën 02.01.2026.
- Është lartpërmendura nëse nuk arrin të fitoj të zgjidhet deputetë në Kuvendin të Kosovës e ruan të drejtën e kthimit në vendin e punës pas përfundimit të pezullimit nga data 03.01.2026.
- Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të përcjellë Vendimin tek Divizioni i Pagesave në Ministrinë e Financave për Emina Coković, të cilës i është për pezulluar marrëdhënia e punës sipas pikës 2 të këtij vendimi dhe të futet në listën e pagave me zero.
- Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Drejtoria për buxhet dhe financa dhe Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.
- Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për Ankesa në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi

Vendimi i dërgohet:

- Emina Coković,
- Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
z.Illir FERATI





Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr.1386 /2025
Data: 16.12.2025

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13, nenin 17 pika k) dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010 i miratuar me datën 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën 06.Nr.148/2025 të datës 12.12.2025 të parashtruar nga Drejtoria për Mirëqenie Sociale, për ndarjen e mjeteve buxhetore sipas kontratës për qira 01.Nr.1384/2025 të datës 16.12.2025 dhe i propozon kryetarit të komunës të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 06.Nr.148/2025 e datës 12.12.2025, e parashtruar nga Drejtoria për Mirëqenie Sociale, për ndarjen e mjeteve buxhetore sipas kontratës për qira 01.Nr.1374/2025 të datës 15.12.2025 dhe ndahen mjete buxhetore për pagesën e qirasë për znj. Blerta Bajramaj, në shumë prej 1200€ (Njëmijedyqind euro) për gjashtë (6) muaj.
2. Pagesa e mjeteve financiare bëhet nga 200€ (Dyqind euro) në muaj, për gjashtë muaj në xhironlogarinë bankare të znj. Blerta Bajramaj – si përfituese nga programi buxhetor i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nënprogrami buxhetor shërbime sociale.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Mirëqenie Sociale.
4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap Konflikt Administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentit për Çështje Administrative, brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pronimit të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- znj. Blerta Bajramaj adresa rruga "Shaban Manaj" Istog
- Drejtorisë për Mirëqenie Sociale si dhe,
- Arkivit të zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Istogut
Opština Istok - Municipality Istog



Kryetari / Predsednik / Mayor

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

01 Nr. 1385/2025

Data: 16.12.2025

Kryetari i Komunës, bazuar ne Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne Nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), Nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 i miratuar me datë 30.11.2010 dhe nenin 4 paragrafi 1 nenparagrafi 1.9 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 001Nr.146/2025. Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare në Zyrën për Komunitete, shqyrtoi kërkesën 10Nr.553-46118 të datës 16.12.2025 të parashtruar nga Amra Guberinić nga Lubovë Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për blerjen e barnave dhe trajtimin mjekësor për djalin e sajë me procesverbal. 10Nr.35/2025 të datës 16.12.2025 i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

- MIRATOHET:** kërkesa 10Nr.553-46118 të datës 16.12.2025 të parashtruar nga Amra Guberinić për përkrahje financiare për blerjen e barnave dhe trajtimet mjekësor për djalite sajë Kenan Guberinić dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **treqind euro, 300.00€** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetori Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.
- Mjetet financiare të miratuar në pikën 1 të këtij Vendimi do të transferohen në xhirollogarinë e Amra Guberinić në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
- Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.
- Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap Konflikt Administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda një afati prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Amra Guberinić
- Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
z.Illir FERATI





Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr.1383/025
Data: 16.12.2025

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13, nenin 58 pika f), nenit 62 paragrafi 62.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 74 paragrafi 74.2 të Statutit të Komunës Nr.62/010 të datës 30.11.2010, për larimin nga detyra e Drejtorit të Drejtorisë për Inspektion, nxjerr:

V E N D I M

1. z.Kushtrim Buleshkaj, lirohet nga detyra e Drejtorit të Drejtorisë për Inspektion dhe obligohet Zyrtarja Financiare-Përgjegjëse për Paga Mëditje dhe Kompensime të largoj nga lista e pagave në pozitën e Drejtorit nga data 18.12.2025.
2. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.
3. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- z.Kushtrim Buleshkaj,
- Menaxheri i Burimeve Njerëzore,
- Zyrtarja Përgjegjëse për Paga Mëditje dhe Kompensime,
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Kryetari Komunës
z.Illir FERATI





Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr.1382/025
Data: 16.12.2025

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13, nenin 58 pika f), nenit 62 paragrafi 62.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 74 paragrafi 74.2 të Statutit të Komunës Nr.62/010 të datës 30.11.2010, për larimin nga detyra e Drejtorit të Drejtorisë për Shërbime Publike, nxjerr:

V E N D I M

1. z.Abedin Kabashi, lirohet nga detyra e Drejtorit të Drejtorisë për Shërbime Publike dhe obligohet Zyrtarja Financiare-Përgjegjëse për Paga Mëditje dhe Kompensime të largoj nga lista e pagave në pozitën e Drejtorit nga data 18.12.2025.

2. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

3. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- z.Abedin Kabashi,
- Menaxheri i Burimeve Njerëzore,
- Zyrtarja Përgjegjëse për Paga Mëditje dhe Kompensime,
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr.1380/025
Data: 16.12.2025

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13, nenin 58 pika f), nenit 62 paragrafi 62.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 74 paragrafi 74.2 të Statutit të Komunës Nr.62/010 të datës 30.11.2010, për larimin nga detyra e Drejtorit të Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër, nxjerr:

V E N D I M

1. z. Agon Dreshaj lirohet nga detyra e Drejtorit të Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër dhe obligohet Zyrtarja Financiare-Përgjegjëse për Paga Mëditje dhe Kompensime të largoj nga lista e pagave në pozitën e Drejtorit nga data 18.12.2025.

2. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

3. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- z. Agon Dreshaj,
- Menaxheri i Burimeve Njerëzore,
- Zyrtarja Përgjegjëse për Paga Mëditje dhe Kompensime,
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.



Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI



Republika e Kosovës-Komuna e Istogut
Republika Kosovo-Opština Istok
Republic of Kosova-Istog Municipality



Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr.1379/025
Data: 16.12.2025

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13, nenin 58 pika f), nenit 62 paragrafi 62.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 74 paragrafi 74.2 të Statutit të Komunës Nr.62/010 të datës 30.11.2010, për larimin nga detyra e Drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi, nxjerr:

V E N D I M

1. z.Zenel Shatri, lirohet nga detyra e Drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe obligohet Zyrtarja Financiare-Përgjegjëse për Paga Mëditje dhe Kompensime të largoj nga lista e pagave në pozitën e Drejtorit nga data 18.12.2025.
2. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.
3. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- z. Zenel Shatri,
- Menaxheri i Burimeve Njerëzore,
- Zyrtarja Përgjegjëse për Paga Mëditje dhe Kompensime,
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Kryetari Komunës
z.Illir FERATI





Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr.1378 /025
Data: 16.12.2025

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13, nenin 58 pika f), nenit 62 paragrafi 62.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 74 paragrafi 74.2 të Statutit të Komunës Nr.62/010 të datës 30.11.2010, për larimin nga detyra e Drejtoreshës së Drejtorisë për Mirëqenie Sociale, nxjerr:

V E N D I M

1. znj.Merita Bytyçi lirohet nga detyra e Drejtoreshës së Drejtorisë për Mirëqenie Sociale dhe obligohet Zyrtarja Financiare-Përgjegjëse për Paga Mëditje dhe Kompensime të largoj nga lista e pagave në pozitën e Drejtorit nga data 18.12.2025.
2. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.
3. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- znj.Merita Bytyçi,
- Menaxheri i Burimeve Njerëzore,
- Zyrtarja Përgjegjëse për Paga Mëditje dhe Kompensime,
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Kryetari Komunës
z.Illir FERATI





Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr.1376/2025
Data: 15.12.2025

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Kryetari i Komunës, bazuar ne Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne Nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), Nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 i miratuar me datë 30.11.2010 dhe nenin 4 paragrafi 1. nenparagrafi 1.1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 001Nr.146/2025. Komisioni për shqyrtimin e kërkesave - Zyrën e Kryetarit , shqyrtoi kërkesën 08Nr.553-37419 të datës 02.10.2025 të parashtruar nga Muhamet Sylaj nga Rakoshi, Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për kompensim të dëmit të shkaktuar nga zjarri dhe me procesverbal të datës 12.12.2025 i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

- 1. MIRATOHET:** kërkesa 08Nr.553-37419 e datës 02.10.2025 e parashtruar nga Muhamet Sylaj për përkrahje financiare për kompensim të dëmit të shkaktuar nga zjarri, djegia e shtëpisë, i cili e ka gjendjen e vështirë ekonomike e me mjete vetanake nuk mund të renovoj shtëpinë e djegur dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej dy mijë e pesëqind euro (2500.00€) nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike.
2. Mjetet financiare të miratuar në pikën 1 të këtij Vendimi do të transferohen në xhirollogarinë e Muhamet Sylaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësive.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike.
4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap Konflikt Administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda një afati prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Muhamet Sylaj,
- Drejtoria për Shërbime Publike
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
z.Illir FERATI





Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr. 1375/2025

Data: 15.12.2025

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Kryetari i Komunës, bazuar ne Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne Nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), Nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 i miratuar me datë 30.11.2010 dhe nenin 4 paragrafi 1. nenparagrafi 1.1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 001Nr.146/2025. Komisioni për shqyrtimin e kërkesave - Zyrën e Kryetarit , shqyrtoi kërkesën 01Nr.553-44304 të datës 01.12.2025 të parashtruar nga Luan Shatri nga Tomoci, Komuna e Istogut, për përkrahje financiare për kompensim të dëmit të shkaktuar nga zjarri dhe me procesverbal të datës 12.12.2025 i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

- 1.MIRATOHET:** kërkesa 01Nr.553-44304 e datës 01.12.2025 e parashtruar nga Luan Shatri për përkrahje financiare për kompensim të dëmit të shkaktuar nga zjarri, djegia e sanës dhe kashtës, i cili e ka gjendjen e vështirë ekonomike e me mjete vetanake nuk mund të siguroj blerjen e ushqimit për kafshë dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej tetëqind euro (800.00€) nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike.
2. Mjetet financiare të miratuar në pikën 1 të këtij Vendimi do të transferohen në xhirollogarinë e Luan Shatri, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësiave.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike.
4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap Konflikt Administrativ pranë Gjykatës Komerciale në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda një afati prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Luan Shatri,
- Drejtoria për Shërbime Publike
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
z.Illir FERATI





Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr.1373/2025
Data: 15.12.2025

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Kryetari i Komunës, bazuar ne Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne Nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 12 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1. dhe si dhe neni 11 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 001Nr.146/2025 i miratuar me datë 31.07.2025, Drejtoria për Mirëqenie Sociale, shqyrtoi kërkesën 06-Nr.553-41833 të datës 06.11.2025 të parashtruar nga Kujtim Tafilaj nga fshati Rakosh Komuna e Istogu, për përkrahje financiare për nënën Naxhije Tafilaj familjet dhe kategoritë me nevojë i cili jeton në kushte të vështira socio-ekonomike dhe me procesverbal Nr.142/2025 i datës 24.11.2025, i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

- MIRATOHET:** kërkesa 06Nr.553-41833 e datës 06.11.2025 e parashtruar nga Kujtim Tafilaj për përkrahje financiare për nënën Naxhije Tafilaj për familje me nevojë e cili jeton në kushte të vështira socio-ekonomike dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej dyqind e pesëdhjetë euro (250.00€) nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale.
- Mjetet e cekura në pikën 1 të këtij Vendimi do të transferohen në xhirollogarinë e Kujtim Tafilaj në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësiive.
- Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Drejtoria për Mirëqenie Sociale.
- Vendimi është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap Konflikt Administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda një afati prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Kujtim Tafilaj,
- Drejtoria për Mirëqenie Sociale dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI





Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr.1372/2025
Data: 15.12.2025

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Kryetari i Komunës, bazuar ne Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne Nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 12 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1. dhe 1.2 nën paragrafi 1.7. të rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 001Nr.146/2025 i miratuar me datë 31.07.2025, Drejtoria për Mirëqenie Sociale,shqyrtoi kërkesën 06Nr.553-43715 të datës 25.11.2025 të parashtruar nga Kujtim Zogaj nga fshati Kaliqan Komuna e Istogu, për përkrahje financiare për familjet dhe kategoritë me nevojë i cili jeton në kushte të vështira socio-ekonomike dhe me procesverbal Nr.153/2025 i datës 12.11.2025, i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

- 1. MIRATOHET:** kërkesa 06Nr.553-43715 e datës 25.11.2025 e parashtruar nga Kujtim Zogaj për përkrahje financiare për familje me nevojë e cili jeton në kushte të vështira socio-ekonomike dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej dyqind treqind e pesëdhjetë euro 350.00€ nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale.
2. Mjetet e cekura në pikën 1 të këtij Vendimi do të transferohen në xhirollogarinë e Kujtim Zogaj në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësiave.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Drejtoria për Mirëqenie Sociale.
4. Vendimi është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap Konflikt Administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda një afati prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Kujtim Zogaj
- Drejtoria për Mirëqenie Sociale dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI





Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr.1371/2025
Data: 15.12.2025

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Kryetari i Komunës, bazuar ne Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne Nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 12 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6.të rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 001Nr.146/2025 i miratuar me datë 31.07.2025, Drejtoria për Mirëqenie Sociale, shqyrtoi kërkesën 06-Nr.553-41818 të datës 06.11.2025 të parashtruar nga Lumnije Maraj nga fshati Vrellë Komuna e Istogu, për përkrahje financiare për familjet dhe kategoritë me nevojë nënë vetushqyese dhe jeton në kushte të vështira socio-ekonomike dhe me procesverbal Nr.149/2025 i datës 12.11.2025, i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

